



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:305167

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05463590

P.nr.2023:305168

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B., me vendbanim në Shtime, rrugën “ ”, i akuzuar për shkak të veprës penale “ Keqpërdorimi i besimit” nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, (të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082) në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1702/2023 të datës 18.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të Prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarit Y.T., dhe të akuzuarit F.B., me datën 20.02.2024 mori publikisht komunikoi, ndërsa me datë 18.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

- **F.B.**, me vendbanim në rrugën “ ... ”, në Shtime, i lindur më dt.... në Shtime, nga i ati H. e ëma N. e gjinisë H., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër tel 04..., mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- Me datën 17.02.2023 në rrugën “ ... ” në Shtim, e saktësisht në punëtorin për përpunimin e llamarinës “M.”, ka keqpërdorë autorizimet e tij me qëllim që vetes ti sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që i pandehuri në cilësinë e punëtorit pa njohurin e pronarit Y.T. nga punëtorja kishte marr pjesë metalike(copëza) të metalit rreth 170 kg, të cilat i kishte shitur në një hekurishte për 37 euro dhe 450 kg llamarinë (material për 300 copë qynka për kamina) të cilat i kishte shitur personit M.A. në vlerë prej 300 euro , me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm pasuror,

- me të cilën ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i besimit ” nga neni 330 par.1 lidhur të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim dhe neneve 4, 7, 17, 38, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 71, dhe të nenit 330 par 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364,449 ,462 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarit **F.B.**, i shqipton:

- dënimi me gjobë në shumë prej 100 / njëqind / Euro, të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

- dënimi me kusht me burg katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20.00.-Euro (njëzet) euro të gjobës.

- Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30.00 .-Euro,(tridhjetë euro) ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej e 20.00 .-Euro (njëzet euro,) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- I dëmtuari dëshmitarit Y.T. me adresë banimi në rrugën “...” nr.... në Shtime , për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1702/2023 të datës 18.12.2023, kundër të akuzuarit F.B., me vendbanim në Shtime, rrugën “ ... ”, për shkak të veprës penale “ Keqpërdorimi i besimit” nga neni 330 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 20.02.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, i dëmtuari Y.T., dhe të akuzuarit F.B.

Konform nenit 241 paragrafi të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), të akuzuarin F.B., gjyqtari i vetëm gjykues e ka udhëzuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën për veprën penale që akuzohet, dhe i ka ofruar mundësinë të pranoj

fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

I akuzuari F.B., për verën penale që akuzohet ka deklaruar se pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza, dhe e mbështet deklaratën e tij të dhënë në polici 03.03.2023, i kërkon falje palës së dëmtuar që është prezent në seancën gjyqësore, pasi edhe ka punuar te punëtorja “ M. ”, për përpunimin e llamarinës ,dhe nga kryerja e kësaj vepre penale jam larguar nga aty, i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të ketë parasysht rrethanat lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjyqtari në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ky pranim është bere vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshme për pasojat e pranimin kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, kërkojmë nga gjykata qe të njëjtën ta shpalle fajtor dhe ta dënoj konform ligjit duke pas parasysht te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese dhe me sanksionin e shqiptuar te arrihet qëllimi i dënimit. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit si rrethanë rënduese të merr shkallen e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës penale e që në rastin konkret ka qenë qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore për vete, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, në rastin konkret i dëmtuari të pandehurit i ka besuar në ruajtje, pasurisë kurse si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

I dëmtuari Y.T., ka deklaruar se bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe e mbështes prokurorin e shtetit që deklaroi lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbetem pran kërkesës pasurore-juridike ku do ta inicion procedurën për kompensim dëmi në procedure kontestimore.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit Raportit të oficerit të dt.03.03.2023, deklarata e të dëmtuarit të dhënë në polici me date 03,03,2023, deklarata e dëshmitarit I.B. të dhënë në polici me date 03.03.2023,deklarata e dëshmitarit M.A. të dhënë në polic me date 03.03.2023, deklarata e të pandehurit të dhënë në polici me date 03.03,2023 shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen elementet e veprës penale “ Keqpërdorimi i besimit” nga neni 330 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitharrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim falje shprehur të dëmtuarit, Gjkata duke pas parasysh se ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe është penduar thellë për veprën e kryer penale, në përputhje me nenin 71 dhe 72 të KPK-së, vendosi që ndaj të njëjtit të shqiptoj dënim me gjobë në minimum bazuar në nenin 43 par.1 të KPRK-së dhe dënim burgimi me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla të kundërligjshme. Gjkata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në “parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil është marrë në pajtim me nenin 460 të KPP-së

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së

nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPP-së.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr. 2023:305168 me datë 18.03.2024

Zyrtare ligjore
Arbelinda Tahiri

Gjyqtari,
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.